



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:008699  
Datë: 24.04.2024  
Numri i dokumentit: 05614649

C-II-17-0452-C0001

Paditësi; I Mi përfaqësuar nga K B nga Prishtina, i autorizuar nga Sindikata e Pavarur e ish punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim).

Kundër

Të paditurës; Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, rruga: "Dritan Hoxha", nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit; Asllan Krasniqi, me datën; 24.04.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, I M e me të cilën ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve nga Lista Përfundimtare legjitime e publikuar nga AKP-ja me datat 4, 5 dhe 7 Mars të vitit 2009, të vërtetohet e drejta në pagesën nga fondi i 20 %, si e drejtë e fituar me Listën e shpallur nga AKM-ja me datat, 4, 5 dhe 7 mars 2009, në tërësi, dhe të detyrohet AKP-ja, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, të u paguaj secilit edhe shumën prej 5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që iu ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSH-së, kjo pagesë të bëhet në afatin kohor prej 15 ditësh llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësit, I M etj, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kanë parashtruar padinë e përbashkët prej 535 ish punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim) për kompensimin e dëmit – mos pagesën e 20 % -it në tërësi sipas Listës Përfundimtare të publikuar në mjetet e informimit me dt.04. 05 dhe 07 Mars të vitit 2009 e me propozimin që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, të nxjerr aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditësve nga Lista Përfundimtare legjitime e publikuar nga AKP-ja me datat 4, 5 dhe 7 Mars të vitit 2009, vërtetohet e drejta në pagesën nga fondi i 20 %, si e drejtë e fituar me Listën e shpallur nga AKM-ja me datat, 4, 6 dhe 7 mars 2009, në tërësi, dhe të detyrohet AKP-ja, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, t'iu paguaj secilit edhe shumën prej;5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që u ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i

shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSH-së, dhe pagesa të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim.

Paditësit në këtë padi në mes tjerash kanë theksuar se janë përfitues të 20 %-shit nga privatizimi i NSH, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, të cilën AKM-ja, e ka privatizuar me dt.27.06.2006, nga Lista përfundimtare e të të punësuarve në NSH në momentin e privatizimit, e cila ishte hartuar konform dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, nenet 10.1- 10.4 me ndryshimet e saj si dhe me Udhëzimin Administrativ, (UA), të UNMIK-ut, Nr.2008/6, se kjo listë pasi që është përpiluar nga organi përfaqësues i ndërmarrjes, iu ishte dorëzuar AKM-së, gjegjësisht Komisionit për përpilimin e Listës Përfundimtare të përfituesve të së drejtës së përfitimit nga Fondi i 20 %-it të NSH-së, se komision kishte përpiluar Listën Përfundimtare të të punësuarve legjitim të cilët në momentin e privatizimit ishin të punësuar në NSH dhe ishin në listën e pagave të këtij subjekti më shumë se tri vite, andaj me subjektin e privatizuar kishin raporte të veçanta dhe në të kishin një vend pune, se Lista Përfundimtare e AKM-së e përpiluar nga komisioni adekuat dhe e vërtetuar nga Bordi i Drejtorëve të AKM-së, u publikua në disa prej mediave ditore të informimit sipas nenit 10.3 të UNMIK-ut, Nr.2003/13, me dt.4, 5 dhe 7 mars 2009, se Lista Përfundimtare i kishte përfshirë vetëm punëtorët të cilët i plotësonin kushtet sipas Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, neni 10.1, dhe 10.4 me ndryshimet e saj me Udhëzimin Administrativ, (UA), të UNMIK-ut, Nr.2008/6, në momentin e privatizimit, edhe 98 të cilët nuk i plotësonin kushtet në tërësi sipas dispozitave ligjore. Tutje kanë shtuar se pas shpërndarjes së pagesave me ç' rast secili individ nga Lista Përfundimtare, e kuptuan se i janë shkelur të drejtat e tyre legjitime dhe janë dëmtuar secili prej tyre për nga 5,060.00 € e me këtë shpërndarje të kryer nga ana e AKP-së dhe me kontestin e zhvilluar në Dhomën e Posaçme, se të punësuarit pasi që nuk kanë qenë palë në procesin gjyqësor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk kanë qenë të informuar në asnjë mënyrë për këtë procedurë as nga Dhoma e Posaçme e as nga AKP-ja, pasi që kanë marrë kështu e detytë ata e kanë themeluar një këshill prej 19 anëtarësh nga Lista Përfundimtare e të punësuarve, se paditësit janë dëmtuar me veprimet dhe me mosveprimet e AKP-së, të cilat mund të shihen në procedurën e zhvilluar në Dhomën e Posaçme me shifrën, SCEL-09-0001 dhe ASC-11-0035, se në shkallën e parë, Trupi gjyqësor, ua kishte aprovuar ankesat e 735 ankuesve të Listës Përfundimtare dhe legjitime të AKP-së, duke e shpallë "nule" Listën Përfundimtare të të punësuarve e duke e udhëzuar të paditurën që të përgatis "një listë të re" për shkaqe procedurale (përbërja e komisionit) e më gjerësisht si në këtë padi.Me dt.30.10.2013, e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje në padinë e paditësve për kompensimin e dëmit respektivisht për mos pagesën e 20 %-it në tërësi sipas Listës Përfundimtare të publikuar nga AKP-ja në muajin mars 2009, se paditësit kanë theksuar se ankesën e kanë parashtruar kundër Listës përfundimtare të publikuar nga AKP-ja për arsye se në këtë listë janë përfshirë edhe 98 persona të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, se trupi gjyqësor i DhPGJSK-së, ka refuzuar ankesat e tyre e me të cilin përveç 98 punëtorëve të pranuar nga AKP-ja, i kishte përfshirë në këtë listë për përfitimin e 20 %-it edhe 714 ankues në kundërshtim me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13 dhe se ata tash kanë parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, se DhPGJS, gabimisht ka komentuar dhe konkluduar në lidhje me statusin e Ndërmarrjes shoqërore, KNI "Ramiz Sadiku", se paditësit siç duket nuk janë kënaqur me Vendimet e DhPGJS lidhur me përfshirjen në listë edhe të një numri të madh ankuesish, dhe se në këtë mënyrë ata janë të dëmtuar, se paditësit kërkojnë nga DhPGJS, që të merr aktgjykim e me të cilin aprovohet padia e paditësve dhe të detyrohet, AKP-ja, që 535 punëtorëve të përfshirë në Listën Përfundimtare të publikuar në vitin 2009, t'u paguaj edhe nga 5,060.00 euro.Po ashtu në këtë mbrojtje, ka sqaruar rrjedhën e procedurës dhe para publikimit të Listës Përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku", Prishtinë dhe të publikuar në vitin 2009 e deri te nxjerrja e aktgjykimi të Kolegjit të DhPGJS-së, SCEL-09-0001 të dt.10.06.2011, e me të cilin është pranuar një numër të madh të ankesave si të bazuar dhe e urdhëroj AKP-në, që t'i përfshij në Listën Përfundimtare për 20 %-it derisa pjesërisht e ka pranuar si të bazuar ankesën e ankuesve, C 540-1 e duke i hequr nga lista 8 punëtorë dhe duke e refuzuar ankesën për heqjen e punëtorëve të tjerë e më pas, pas ankesës së ushtruar nga AKP-ja dhe Sindikata e Punëtorëve të NSH-së në fjalë kundër këtij aktgjykimi, Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së, me aktgjykimin e tij, ASC-11-0069-A00073 të dt.24.11.2011, ka pranuar një numër të madh të ankesave të punësuarve dhe e urdhëroj AKP-në, që t'i përfshij ata në Listën Përfundimtare për 20 %-i ndërsa e refuzoj si të pabazuar ankesën e AKP-së, Nr.A 0016 dhe të Sindikatës së Punëtorëve të NSH-së, Nr.A0073.

AKP-ja në mbrojtjen e parashtruar ka deklaruar se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësve të paraqitura në padinë e tyre e duke i konsideruar si të pabazuara, se në lidhje me Listën Përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë një pjesë të ardhurave nga privatizimi i NSH, "Ramiz Sadiku", Prishtinë, në kohën e paraqitjes së ankesave (në vitin 2009) dhe marrjes së aktgjykimit (në vitin 2011), ka qenë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut, Nr.2003/13 (me ndryshime), Rregullorja Nr.2008/4, Udhëzimi Administrativ, Nr.2008/6, se Rregullorja e UNMIK-ut, Nr.2003/13, neni 10.6, thekson se : ***"Pas paraqitjes së kërkesës nga individ apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garanci mbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5 , i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1. (g) të Rregullores, Nr.2003/13"***, se neni 10.6 (a), thotë se: ***"Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes së Listës Përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 103 të Listës së të punësuarve me të drejta legjitime"***, se Trupi gjykues dhe Kolegji i Ankesave i DhPGJS-së në lëndën, SCEL-09-0001 dhe ASC-11-0069-A00073, kanë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet e Sindikatës së Punëtorëve të NSH-së, duke dhënë arsyet sepse ankesat e tyre janë refuzuar, prandaj konsiderojnë se çështja ka përfunduar, pasi që nuk është paraparë asnjë mundësi tjetër ligjore për të kundërshtuar Listën Përfundimtare, as me ligjet që ishin në fuqi as me ligjet që tash janë në fuqi (Ligji, Nr.04/L-034 për AKP-në), se në bazë të Rregullores, Nr.2008/4, Udhëzimi Administrativ, 2008/6, Udhëzimi Administrativ, Nr.2008/6, dhe Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në,

Vendimet e Kolegjit të Apelit janë përfundimtare dhe ndaj tyre nuk mund të ushtrohet ndonjë ankesë tjetër, se siç shihet nga e tëra që u tha më lartë, paditësit pretendojnë se përveç 98 punëtorëve të përfshirë në Listë nga AKP-ja, janë përfshirë edhe 714 punëtorë të tjerë nga Dhoma e Posaçme, dhe në këtë mënyrë punëtorët e përfshirë në listën e shpallur në mars së vitit 2009, janë dëmtuar secili prej tyre për nga 5,060.00 euro, se fakti i thjeshtë se paditësit, janë të pa kënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të parashtrojnë sërish ndonjë ankesë tjetër apo padi të bazuar në ligj për të njëjtën çështje, pasi që çështja është gjë e gjykuar (res iudicata), e kjo është argumentuar edhe me një numër të konsiderueshëm me Vendime të Kolegjit të Apelit lidhur me NSH "Ramiz Sadiku" si psh, AC-1-12-0145, AC-1-13-0174, AC-1-12-0145, ASC-11-0069-A0104 etj, se po ashtu sipas nenit 24 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 për AKP-në (ligji i vjetër), thuhej se : ***"Secili parashtrues dhe palë kundërshtare përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës apo i odës së avokatëve"***.

### **Arsyvetimi ligjor:**

Në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit, Nr.06L/086 të DhPGJSK-së, vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente. Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditësit, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata konstaton se Ndërmarrja Shoqërore "Ramiz Sadiku" me seli në Prishtinë (në likuidim), është privatizuar nga ish AKM-ja me dt.27.06.2006 kurse paditësi sikurse edhe të punësuarit e tjerë të kësaj NSH-ja, ka qenë përfitues i 20 %-it nga privatizimi i kësaj NSH-je, dhe atë nga Lista Përfundimtare e të të punësuarve në NSH në momentin e privatizimit dhe e hartuar sipas nenit 10.1, 10.2, 10.3 dhe nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13 e me ndryshimet e saj si dhe me Udhëzimin Administrativ, (UA), të UNMIK-ut, Nr.2008/6 dhe se i njëjti, ka marrë shumën prej 3,500.00 euro dhe e cila ia ishte paguar, në dy këste. Mirëpo duke qenë se në rastin konkret, Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me aktgjykimin e saj të nxjerrë në shkallë të parë, SCEL-09-0001 të dt.10.06.2011 e me të cilin është pranuar një numër i madh të ankesave si të bazuara dhe e ka urdhëruar AKP-në, që t'i përfshij në Listën Përfundimtare për 20 %-it derisa pjesërisht e ka pranuar si të bazuar ankesën e ankuesve, C -540 -1 e duke i hequr nga lista 8 punëtorë dhe duke e refuzuar ankesën për heqjen e punëtorëve të tjerë e pas ankesës së ushtruar nga AKP-ja dhe Sindikata e Punëtorëve të NSH-së në fjalë kundër këtij aktgjykimi. Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së, me aktgjykimin e tij, ASC-11-0069-A00073 të dt.24.11.2011, i ka pranuar një numër të madh të ankesave të punësuarve dhe e urdhëruar, AKP-në, që ata t'i përfshij në Listën Përfundimtare për 20 %-i ndërsa ua ka refuzuar si të pabazuar ankesën e AKP-së, Nr. A 0016 dhe

ankesën e Sindikatës së Punëtorëve të NSH-së, Nr.A0073 derisa kërkesa për kompensimin e dëmit - për mos pagesën e 20%-it në tërësi sipas Listës Përfundimtare të publikuar në mjetet e informimit me dt.4, 5 dhe 7 mars 2009, është bërë brenda afatit të paraparë nga neni 72 i Ligjit Nr.06/L-086 të DhPGJSK-së që bënë fjalë për Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime dhe se kjo kërkesë i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë në kuptim të nenit 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 dhe 72 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata ka vlerësuar se me këtë gjendje të tillë të shkresave të lëndës, Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë kompetente për të vendosur, konstaton se objekti i kësaj çështje juridike kontestimore lidhur me kompensimin e kërkuar të paditësve dhe që të detyrohet AKP-ja, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, t'u paguaj secilit edhe nga 5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që u ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSH-së,

Në nenin 72 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), që flet për Ankesat lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime. Aty thuhet se :'' *Përveç nëse nuk përcaktohet saktësisht me këtë nen, procedura për lëndët që bazohen në ankesat që bien nën paragrafin 1.6 të nenit 5 të Ligjit për Dhomen e Posaçme do të ndjek rregullat e tjera procedurale të përshkruara në këtë ligj e që Dhoma e Posaçme i zbaton mutatis mutandis nëse i vlerëson si të domosdoshme dhe në interes të drejtësisë. Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpall listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/apo duke sfiđuar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë. Personi i cili parashtron një kërkesë apo kundërshtim të tillë, do të përfshijë aty në deklaratë të fakteve dhe argumenteve ligjore që mbështesin kërkesën apo kundërshtimin e tillë; ai person ka barrën e dëshmisë për të gjitha faktet e pretenduara në kërkesë dhe/apo në kundërshtim*''.

Në rastin konkret, e paditura, ish AKM-ja, e tani AKP-ja, e ka privatizuar me dt.27.06.2006, dhe e ka hartuar Listën përfundimtare e të të punësuarve në NSH në momentin e privatizimit, e cila ishte hartuar konform dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, nenet 10.1, 10.2, 10.3, dhe 10.4 me ndryshimet e saj si dhe me Udhëzimin Administrativ, (UA), të UNMIK-ut, Nr.2008/6, pra se kjo listë ishte përpiluar nga organi përfaqësues i ndërmarrjes, i ishte dorëzuar ish AKM-së, gjegjësisht Komisionit për përpilimin e Listës Përfundimtare të përfituesve të së drejtës së përfitimit nga Fondi i 20 %-it të NSH-së, e më pas se komision kishte përpiluar Listën Përfundimtare të të punësuarve legjitim të cilët në momentin e privatizimit ishin të punësuar në NSH dhe ishin në listën e pagave të këtij subjekti më shumë se tre viteve, se Lista Përfundimtare e AKM-së e përpiluar nga komisioni adekuat dhe e vërtetuar nga Bordi i Drejtorëve të ish AKM-së, ishte e publikuar në disa prej mediave ditore të informimit sipas nenit 10.3 të UNMIK-ut, Nr.2003/13, me dt.4, 5 dhe 7 mars 2009, dhe se në këtë Lista Përfundimtare i kishte përfshirë vetëm punëtorët të cilët i plotësonin kushtet sipas Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2003/13, neni 10.1, dhe 10.4 e me ndryshimet e saj me Udhëzimin Administrativ, (UA) të UNMIK-ut, Nr.2008/6, në momentin e privatizimit, andaj me gjendjen e tillë, nuk është paraparë asnjë mundësi tjetër ligjore për të kundërshtuar Listën Përfundimtare, as me ligjet që ishin në fuqi as me ligjet që tash janë në fuqi (Ligji, Nr.04/L – 034 për AKP-në), se në bazë të Rregullores, Nr.2008/4, Udhëzimi Administrativ, 2008/6, Udhëzimi Administrativ, Nr.2008/6, dhe Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në si dhe se nga Kolegji i Ankesave i DhPGJS-së në lëndën, SCEL-09-0001 dhe ASC-11-0069-A00073, kanë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet e Sindikatës së Punëtorëve të NSH-së, se pas me vendimmarrjes në fjalë, dhe në bazë të sqarimeve të bërë nga e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë. Në Përgjigjen e saj të dt.22.11.2023, gjykata ka vlerësuar se çështja e paditësit, ka përfunduar, pasi që nuk është paraparë asnjë mundësi tjetër ligjore për të kundërshtuar, Listën Përfundimtare, andaj si rezultat i këtij qëndrimi, rrjedh përfundimi se në rastin konkret, janë plotësuar kushtet ligjore që kërkesëpadinë e paditësit, I M me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, që paditësve nga Lista Përfundimtare nga numri rendor 1 deri në 535 të saj, t'ua paguaj secilit edhe nga 5,060.00 euro përveç shumës prej 3,500.00 euro që u ishte paguar, në dy këste, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore nga momenti i shpalljes së Listës e deri te pagesa përfundimtare nga Fondi i Privatizimit të NSH-së, duhet refuzuar si të pa pabazuar.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

### Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

### KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi